

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Institutit të Statistikave (INSTAT) dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), për realizimin e Anketës së Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2026 në Shqipëri, INSTAT shpall thirrje për aplikim (kontrate te perkohshme) nga kandidatet femra të interesuara për angazhim në punë në terren, për pozicioin dhe detyrat e përshkruara më poshtë:

KONTROLLOR

Shpërndarja e pozicioneve sipas bashkive (link):

https://www.instat.gov.al/media/weheookf/copy-of-shperndarja-e-punonjesve-sipas-garqeve_mics-2026.pdf

- Afati aplikimit: 16.12.2025
- Periudha e trajnimit: 07.01.2026 – 23.01.2026
- Periudha e terrenit: 26.01.2026 – 26.03.2026

Trajnimi është i detyrueshëm cdo ditë. Gjatë këtij trajnimi do të realizohet një proces i vazhdueshëm vlerësimi, dhe në përfundim, vetëm kandidatët e suksesshëm do të për zgjidhen për fazën e punës në terren. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetaret (femra) e Shqipërisë, që janë mbi moshën 18 vjeç, që kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave përkatëse.

Afati për shprehjen e interesit: deri më 16.12.2026.

Mënyra e shprehjes së interesit: pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Instituti i Statistikave, ose me email në adresën: ahoxholli@instat.gov.al.

Detyrat kryesore të Kontrollorit:

- Të gjithë kandidatët do të kenë përgjegjësi raportimi ndaj INSTAT dhe personave të caktuar nga UNICEF.
- Kontrolluesi i terrenit është anëtar i ekipit të terrenit. Ai/ajo është përgjegjës për mirëqenien dhe sigurinë e anëtarëve të ekipit, si dhe për përfundimin e punës së caktuar dhe ruajtjen e cilësisë së të dhënave. Kontrolluesi i terrenit i merr detyrat e tij/saj nga koordinatori i terrenit dhe raporton te ai.
- Përgjegjësitë specifike të kontrolluesit të terrenit janë të bëjë përgatitjet e nevojshme për punën në terren, të organizojë dhe drejtojë mbledhjen e të dhënave në ndarjet (clusterat) e përzgjedhura që i janë caktuar, si dhe të kryejë kontrolle të pjesshme mbi të dhënat e mbledhura në Listën e Anëtarëve të Njësisë Ekonomike Familjare, por edhe në çdo modul tjetër sipas rastit.
- Të sigurojë listat e njësive familjare të përzgjedhura dhe hartat për çdo zonë ku ekipi i tij/saj do të punojë dhe të diskutojë çdo çështje të veçantë, si p.sh. gjendjen e mundshme të sigurisë në disa zona.
- Të njihet mirë me zonën ku ekipi do të punojë dhe të përcaktojë mënyrat më të mira për udhëtim

- Pjesëmarrje në trajnimin e MICS dhe njohjen e detajuar me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative për realizimin e anketës, përfshirë: pyetësin e njësisë ekonomike familjare; pyetësin individual për gratë; pyetësit për fëmijët nën moshën pesë vjeçare; pyetësit për fëmijët e moshës 5-17 vjeçare;
- T'u caktojë punën anketuesve, duke u siguruar që ngarkesa e punës të jetë e shpërndarë në mënyrë të barabartë.
- Të raportojë vazhdimisht dhe të sigurohet që detyrat po realizohen.
- Të vëzhgojë intervistat çdo ditë për të monitoruar përparimin e anketuesve si në sjellje ashtu edhe në cilësinë e të dhënave të mbledhura.
- Të sinkronizojë në mënyrë të vazhdueshme aplikacionin CAPI me anketuesit, sa herë që ata përfundojnë intervista/njësi familjare.
- Të sinkronizojë rregullisht (çdo ditë) aplikacionin CAPI me zyrën qendrore, për të ngarkuar pyetësit e përfunduar dhe të dhënat e progresit për koordinatori i terrenit dhe për të mbajtur qendrën të informuar për vendndodhjen e ekipit. Sinkronizimi lejon gjithashtu zyrën qendrore të dërgojë çdo përditësim në aplikacionin e mbledhjes së të dhënave.
- Koordinimin, udhëheqjen dhe monitorimin e punës së ekipit në terren, duke siguruar që të gjitha detyrat të kryhen në përputhje me udhëzimet.
- Të përpiqet të zhvillojë një frymë pozitive ekipi. Një atmosferë e mirë pune, së bashku me planifikimin e kujdesshëm të aktiviteteve të terrenit, kontribuon në cilësinë e përgjithshme të anketës.

Monitorimi i performancës së anketuesve kërkon që kontrolluesi:

- Të vëzhgojë intervistat çdo ditë.
- Të kryejë kontrole të rastësishme sipas nevojës dhe minimalisht aq sa kërkohet nga aplikacioni i mbledhjes së të dhënave.
- (3) Të zhvillojë seanca të rregullta rishikimi me anketuesit dhe t'i këshillojë ata për çdo problem të gjetur në pyetësit e tyre.

Aftësi të kërkuara:

- Aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunuese;
- Gatishmëri për të punuar në grup dhe për të kontribuar në një mjedis dinamik;
- Aftësi për orientim në terren dhe përdorim të hartave për identifikimin e vendbanimeve dhe objekteve të intervistimit;
- Aftësi të mira organizative dhe fleksibilitet për të punuar sipas nevojës së aktivitetit në terren;
- Të jenë të gatshëm për të përballuar kushtet atmosferike duke pasur parasysh që puna kryhet në terren dhe mund të kërkojë ecje të gjata.

Kualifikimet:

- Preferohet të jenë studentë në nivelin bachelor ose të kenë përfunduar së paku ciklin e parë të studimeve universitare;

- Të kenë përvojë në përdorimin e teknologjisë informative, në veçanti përdorimin e pajisjeve si laptopë dhe/ose tabletë;
- E preferueshme të kenë përvojë të mëparshme në realizimin e anketave dhe intervistimeve të ngjashme në terren.